



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 2276/Prot.
13

Pogradec, më 30.05.2024

VENDIM

Nr. 61, datë 29.05.2024

“PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE ZNJ. MERZA MUÇO, PËR DËMET E SHKAKTUARA
NGA RËNIA E ZJARRIT NË BANESË

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 8, të pikës 1 të nenit 29, të ligjit nr. 139/2015, “Për Veteqeverisjen Vendore”, të neneve 4, 7 dhe 41, të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile” dhe të kapitullit III të V.K.M Nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së Bashkisë Pogradec për mbështetje financiare të shtetasës Merza Muço, për dëmtimin e banesës nga rënia e zjarrit në datën 14.05.2024
2. Miratimin e dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Pogradec.
3. Ti akordojë familjes së shtetasit Merza Muço, ndihmën emergjente në vlerën prej 198 443LEK nga buxheti i Bashkisë Pogradec, fondi i emergjencave civile i destinuar dhe miratuar nga Këshilli i Bashkisë Pogradec për vitin 2024.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Emergjencave Civile, Strehimi dhe Administrimit të Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative, si dhe Drejtoria e Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare të Bashkisë Pogradec.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes:

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola SHKIBELI



1. Miratuar me 23 vota

2. Vota Pro 23

3. Vota Kundër 0

4. Vota Abstenim 0

5. Zbardhur më datë 30.05.2024